



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË		UNIVERSITETI "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI		
Nr. / Br. : 174	Nr. i faq/ Br. str / No. pg 2	
Data / Datum / Date: 29.01.2024 Pejë / Prë		

U.d. Sekretari i Përgjithshëm

Dt. 29.01.2024

Në bazë të Rregullores nr. 3182/2018 për angazhimin e studentëve në punë praktike në administratën e Universitetit "Haxhi Zeka", nenit 38 dhe 41 të Statutit Nr. 04-V-622 të Universitetit "Haxhi Zeka " në Pejë dhe vendimit të Këshillit Drejtues nr.171 dt. 29.01.2024, zyra e U.d. Sekretarit të Përgjithshëm të Universitetit "Haxhi Zeka në Pejë, me dt. 29.01.2024, shpall:

KONKURS PËR ANGAZHIMIN E STUDENTËVE NË PUNË PRAKTIKE NË ADMINISTRATËN E UNIVERSITETIT " HAXHI ZEKA" NË PEJË

Numri i pozitave: Dhjetë (10)

Kohëzgjatja e punës praktike: 6 muaj

Kriteret për përzgjedhjen e studentëve për punë praktike:

- Përzgjedhja e praktikantëve do të bëhet sipas Rregullores nr. 3182/2018 për angazhimin e studentëve në punë praktike në administratën e universitetit "Haxhi Zeka";
- Kandidatët për punë praktike duhet të jenë apsolvent (bachelor) ose të jenë të regjistruar në studimet master apo të kenë përfunduar studimet (gjashtë muajt e fundit) në Universitetin " Haxhi Zeka" në Pejë;
- Në përzgjedhjen e studentëve për punë praktike, do të merret parasysh nota mesatare gjatë studimeve ;
- Periudha e angazhimit në punë praktike është me pagesë , sipas mundësive buxhetore të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim

Kandidatët me rastin e aplikimit duhet të dorëzojnë:

1. CV dhe letër motivuese;
2. Çertifikatën e lindjes;
3. Çertifikatën e notave;
4. Vërtetimin e statusit të studentit (jo më të vjetër se një muaj);
5. Kopjen ose çertifikatën e diplomës bachelor ose master të noterizuar (kandidatët që janë të diplomuar).

Aplikacionet e plotësuar së bashku me kopjet e dëshmive të nevojshme sipas konkursit, duhet të dorëzohen në formë elektronike në e-mail: apliko.online@unhz.eu

Konkursi mbetet i hapur tetë (8) ditë, përkatësisht nga dt. 29.01.2024 deri me dt. 07.02.2024 në ora 16.00.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë me konkurs nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen .

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen. Në procedurën e pranimit të kandidatëve do të bëhet testimi dhe intervista e kandidatëve, të cilët i plotësojnë kushtet sipas konkursit.

Studentët do të jenë të angazhuar me orar të plotë (08.00-16.00) sipas legjislacionit në fuqi .

Kandidatët që nuk pranohen kanë të drejtë ankese në afat prej 2 (dy) ditësh, në Komisionin për shqyrtimin e ankesave në kuadër të UHZ-së.